

RELACIONI ARKITEKTONIK

OBJEKTI: “Krijimi i parkut rekreativ në Lagjen e “Re”” – ZONA A



SHOQERIA “ZENIT&CO” RRUGA Myrteza Topi
Ndertesa 18 Hyrja 7 Ap .38 kodi postar 1017. N Bash 9.

Tel 042278165

cel 0692099065

E-mail zenit06@live.com

Tirane-Albania

Tabela e permbajtjes

1. INFORMACION I SHKURTER PER PROJEKTIN	1
2. HYRJE	1
3. OBJEKTIVAT EDHE DETYRAT	2
1. PËRSHKRIMI I NDËRTESAVE DHE GJENDJA EKZISTUESE	2
Situata ekzistuese	2
2. DIZAJNI KONCEPTUAL	4

1. INFORMACION I SHKURTER PER PROJEKTIN

Objekti në fjalë që do të merret në studim ndodhet në territorin e bashkisë Patos në lagjen “e Re” dhe përbëhet nga 2 zona, përkatësisht zona A dhe Zona B. Zona A, pjese e këtij relacioni kufizohet nga segmentet e rrugëve “Sali Alushi” dhe rruga e “Vreshtit”.

2. HYRJE

Në këtë zonë jetojnë rreth 4228 banorë, të cilët përballen vazhdimisht me mungesën e infrastrukturës dhe hapësirave rekreative. Në të gjithë lagjen mungojnë ambiente për fëmijë të cilët mund ti frekuentojnë në kohën e lirë.

Të dhëna teknike:

Sip(zona A)=2127 m²;

Sip(zona B)=16,488 m²;

Zona Kadastrale: 2890

Zona A: PT_UB_AR1_35/78

Zona B: PT_UB_AR1_35/1200



FIG 1. RILEVIMI TOPOGRAFIK

3. OBJEKTIVAT EDHE DETYRAT

Krijimi i një hapësirë të re për qytetin me qëllim argëtimin e të gjithë grupmoshave. Rigjenerimi i zonave të braktisura dhe shndërrimi i tyre në ambiente plotësisht të sigurta dhe të aksesueshme për banorët.

1. PËRSHKRIMI I NDËRTESAVE DHE GJENDJA EKZISTUESE

Situata ekzistuese

Si një ndër lagjet kryesore të qytetit, prej vitesh nuk ishte realizuar asnjë investim për mirëmbajtjen apo sistemimin e zonës e cila ka dhe një shtrirje të konsiderueshme. Në këtë zonë dominojnë kryesisht banesa private 2-3 katëshe.


Infrastruktura rrugore, kryesisht rrugët e brendshme, kalimet e këmbësorëve i janë nënshtruar rehabilitimit total së fundmi duke ofruar banorëve aksesin e munguar prej vitesh. Në këtë lagje është ndërhyrë duke rehabilituar kanalizimet e ujërave të zeza dhe të bardha, sistemin rrugor dhe trotualet. Gjithashtu rruga është paisur me ndriçim dhe pjesërisht hapësira të gjelbëruara. Problematikë për të gjithë grupmoshat që frekuentojnë dhe jetojnë në këtë lagje është mungesa e hapësirave rekreative. Hapësirat e mundshme për zhvillimin e një parku rekreacioni janë të pa sistemuara, mungojnë parkimet, zona e gjelbëruara, ku gjelbërimi i lartë është zhvilluar në mënyrë të pakontrolluar. Këto dy zona si

pasojë e mungesës së investimeve prej vitesh kanë mbetur të pazhvilluara dhe janë kthyer në zona të cilët nuk frekuentohen dhe grumbullohen inerte të cilat hidhen nga qytetarët duke treguar pa përgjegjshmëri në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Kjo ndërthurje do të inkurajojë një bashkëjetesë harmonike duke kontribuar për ndërtimin e solidaritetit mes brezave.

Fotot e inspektimit në terren:



1. Rehabilitimin e zonës me të gjithë elementët e nevojshëm infrastrukturorë duke marrë në konsideratë planin e përgjithshëm vendor të qytetit të Patosit.
2. Krijimin e kushteve për realizimin e të gjithë shërbimeve të munguara.
3. Ndërtimin e një fushe basketbolli në zonën A.
4. Të përcaktohet sinjalistika vertikale dhe horizontale e domosdoshme.
5. Sugjerojmë shtimin e pemëve dekorative në zonë.
6. Të realizohet ndricimi i zonës sipas parametrave dhe standarde në fuqi. Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat egzistuese të zonës.
7. Kompozimi duhet të marrë në konsideratë dhe kompozimin e hapësirave të pushimit me stola.
8. Të përcaktohet gjithë mobilimi urban i nevojshëm.
9. Raportin e ndikimit në mjedis.



- **Shtrimi i sipërfaqeve të lira**

Pjesët e tjera përreth fushës do të sistemohen dhe shtrihen me pllaka trotuari, të vendosura mbi shtresë rëre dhe cakell për të garantuar drenazhimin dhe qëndrueshmërinë.

- **Ndërtimi i rrugices dhe shkalleve**


Rrugica e aksesit që lidh pjesën e sipërme të rrugës me fushën sportive projektohet në formë shkalle me gjerësi 2.2 m, duke ndjekur natyrshëm pjerrësinë e terrenit. Shkallët projektohen me dimensione standarde ergonomike, me lartësi ngjitjeje 15 cm dhe shkelje 30 cm, duke garantuar komoditet dhe siguri gjatë lëvizjes. Për shkak të ndryshimeve të topografisë, shkallët nuk janë lineare në të gjithë gjatësinë, por ndërpriten në seksione të caktuara për të krijuar sheshpushime të cilat i përshtaten gjendjes së terrenit. Në zonat ku terreni krijon hapësira më të gjera, këto sheshpushime marrin formë të zgjeruar duke krijuar çregullsi të qëllimshme në plan, të cilat shërbejnë si ballkone panoramike, hapësira çlodhjeje, pika ndalimi që nuk pengojnë fluksin e lëvizjes dhe spote ndërvepruese për përdoruesit. Shkallët ndërtohen mbi shtresë betoni me zgare, ndërsa shtresa përfundimtare realizohet me beton me markë të lartë, të pigmentuar me ngjyrë të kuqërremtë, për të siguruar rezistencë të lartë, jetëgjatësi dhe harmonizim vizual me zonën sportive përreth. Në të dy anët e shkallëve vendosen kangjella dekorative metalike që garantojnë siguri për përdoruesit.

- **Rikualifikimi i hapësirave ekzistuese**

Do të kryhet pastrimi, sistemimi dhe rikualifikimi i terrenit ekzistues, duke u adaptuar me projektin e ri. Propozohet risuvatimi i strukture ekzistuese në shesh dhe hidroizolim në mbuleses. Është e rëndësishme të ruhen të gjithë elementet autentik të zones, duke i ruajtur karakterin industrial të zones.


- **Shkallare**


Në anën e fushës sportive propozohet një shkallare me dimensione në plan 18.35 m × 5.30 m, e konceptuar si strukturë e integruar me pjerrësinë natyrore të terrenit. Shkallarja përbëhet nga një seri vend-ujesh me dimensione 80 cm shkelje × 45 cm lartësi, të cilat krijojnë radhë të qarta uljeje për spektatorët dhe përdoruesit e fushës. Aksesimi drejt uljeve realizohet përmes shkallëve anësore, të pozicionuara në të dy krahët e shkallares, të cilat sigurojnë hyrje dhe dalje të pavarur pa penguar qarkullimin.



- **Vendosja e elementëve të uljes dhe mobilimit urban**

Në dy anët e fushës do të ndërtohen stola prej çeliku dhe druri për përdoruesit, ndërsa në pjesën ekzistuese të bordurës së betonit do të krijohen vend-uljeje me shtrese druri te pozicionuar mbi binare druri te fiksuar ne borduren ekzistuese te betonit.





- **Rrjeti i ujërave atmosferikë**

Do të realizohet një sistem grumbullimi dhe largimi të ujërave të bardha me tubacion kryesor PVC Ø200 mm, i vendosur përreth fushës, i lidhur me pikat e shkarkimit ekzistuese.



PROJEKTUES

ZENIT&CO SHPK

Ark. Raimonda Mydinllari